



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PËR KRIJIMIN DHE PJESËMARRJEN NË RRJETIN GREENAL

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet nga palët e interesuara (në vijim *Palët*) për krijimin dhe pjesëmarrjen në Rrjetin GreenAL (Në vijim *Rrjeti*).

Parathënie

Nga përvoja kolektive e shoqërisë civile, e fituar përmes forumeve tematike dhe kombëtare të mbajtura gjatë fazës së parë të GreenAL, u konstatua një mungesë e ndërgjegjësimit mjedisor, unitetit dhe rrjetëzimit midis aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile. Duke u bazuar në këtë përvojë, si pjesë e fazës së dytë të projektit GreenAL “Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile 2024-2027”, partnerët e tij po nxisin krijimin e një *rrjeti* të organizatave dhe aktorëve të tjerë që avokojnë për politika më të mira mjedisore dhe angazhohen në proceset vendimmarrëse mbi to në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

Ky *rrjet* synon të furnizohet dhe fuqizohet përmes angazhimit dhe kontributit të anëtarëve të tij, të cilët do jenë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij. Përmes këtij bashkëpunimi, *Rrjeti* do të luajë një rol në forcimin e mëtejshëm të rolit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në mbrojtjen e mjedisit, promovimin e politikave të qëndrueshme dhe adresimin e sfidave mjedisore.

Neni 1 - Qëllimi dhe objektivi i bashkëpunimit

Rrjeti GreenAL synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve mjedisore, OSHC-ve të tjera jo-mjedisore, ekspertëve, aktivistëve dhe palëve të tjera të interesuara, me qëllim për të mbështetur përpjekjet kolektive për të advokuar dhe zhvilluar iniciativa të përbashkëta mbi sfidat mjedisore, si dhe për të kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të vizibilitetit mbi çështje mjedisore në nivel lokal dhe kombëtar.

Rrjeti synon të arrijë qëllimin, nëpërmjet objektivave të mëposhtme:

1. Forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve mjedisore për të trajtuar në mënyrë proaktive çështjet mjedisore dhe për të përfaqësuar komunitetet e prekura;
2. Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet *Palëve* nëpërmjet shkëmbimeve (takime, forume tematike, deklarata tematike, etj.), për të siguruar një qasje të unifikuar dhe të koordinuar ndaj qeverisjes mjedisore.
3. Rritja e pjesëmarrjes në proceset e vazhdueshme dhe të ardhshme të lidhura me përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së.
4. Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe rritja e përgjegjësisë së shoqërisë dhe vendimmarrësve për sfidat e ndryshimeve klimatike, mbrojtjes së natyrës dhe ndotjes në Shqipëri nëpërmjet advokimit, ndikimit në politika dhe monitorimit të të dhënave të bazuara në prova.

Neni 2 - Organizimi

Çdo anëtar i *Rrjetit* do të caktojë një person përgjegjës për të kontribuar në aktivitetet e tij, i cili/e cila do të angazhohet në mënyrë aktive në proceset dhe iniciativat e *Rrjetit*.

Palët bien dakord për rolet dhe përgjegjësitë e mëposhtme si anëtarë në *Rrjetit*:

- Të marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e *rrjetit*, duke ndarë ekspertizën e tyre dhe duke kontribuar në avokimin dhe ndikimin në proceset e hartimit të politikave mjedisore.
- Të bashkëpunojnë për një komunikim dhe koordinim efektiv ndërmjet anëtarëve të *Rrjetit*.
- Të ndihmojnë në shpërndarjen e rezultateve të *Rrjetit*, për të maksimizuar ndikimin e tij.
- Të kryejnë vlerësime mbi progresin dhe ndikimin e iniciativave të *Rrjetit*, duke përshtatur qasjen sipas nevojës.

Neni 3 - Funksionimi dhe koordinimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në aktivitetet e mëposhtme për të arritur objektivat e *Rrjetit*:

- Dy (2) takime të *rrjetit* në vit për të diskutuar për çështjet mjedisore dhe zhvillime në këtë sektor.
- Aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve për anëtarët e *rrjetit* për të forcuar aftësinë e tyre për adresimin e sfidave mjedisore, si p.sh. trajnime tematike.
- Angazhime për të kontribuar në proceset e politikëbërjes, si dhe angazhimi/koordinimi me aktor të tjerë lokal dhe atyre kombëtar, duke përfshirë organet qeveritare.
- Organizimi/pjesëmarrje në takime, aktivitete, forume tematike dhe asamble kombëtare për të diskutuar çështjet urgjente mjedisore dhe për të zhvilluar strategji/qasje të përbashkëta.
- Kontribut dhe shpërndarje të artikujve, dokumenteve dhe raporteve të statusit të përgjigjeve të politikave mbi Tranzicionin e Gjelbër të Shqipërisë dhe progresin mjedisor.
- Ndarje e multimedive (artikuj, video, etj.) që kanë në fokus çështjet mjedisore, dhe që janë në linjë me objektivat e *rrjetit*, nëpërmjet platformës digjitale GreenAL për të promovuar punën e anëtarëve në territor.

Neni 4 - Konsultimi dhe informimi midis Palëve

- Personi përgjegjës do të përfaqësojë organizatën/palën e interesit në takimet e *rrjetit* dhe do të ndjeki komunikimet dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të *rrjetit*.
- Detajet e kontaktit që *palët* dorëzojnë si pjesë e shtojcës 1, do përdoren si të dhënat kryesore të kontaktit për ta.
- *Palët* nese konsiderojnë që ka zhvillime të cilat mund të jenë me interes për *rrjetin* mund të informojnë pikat e kontaktit dhe të konsultohen për çështjet që konsiderohen të nevojshme për funksionimin e duhur dhe fuqizimin e qëllimit të *rrjetit*.

Me nënshkrimin e këtij Memorandiumi, *palët bien dakord dhe pranojnë* se komunikimi do të jetë në përputhje me pikat e mëposhtme:

- *Palët* do të plotësojnë Shtojcat e këtij Memoriandiumi dhe do të bëhen pjesë e bazës së të dhënave publike të GreenAL në faqen <https://greenal.al/>
- *Palët* bien dakord të përdorin emrin dhe logot e çdo Anëtari të *Rrjetit* në të gjitha komunikimet publike, deklaratat për shtyp, dhe dokumentet publike apo zyrtare, për informacionet që lidhen me dokumentet/punën e *Rrjetit*;
- *Palët* bien dakord që komunikimi në media në emër të *Rrjetit* të jetë i koordinuar dhe që anëtarët e tjerë të informohen për daljet në TV, radio, etj., dhe të diskutohen çështjet që do trajtohen dhe mesazhet kryesore që do përcillen.

Neni 5 - Kohëzgjatja, Përfundimi, Rishikimi

- Ky Memorandum Bashkëpunimi do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar. Përfundimi tij do të realizohet me marrëveshje midis *palëve* të përfshira.
- Mosmarrëveshjet zgjidhen gjithnjë dhe vetëm nëpërmjet mirëkuptimit midis *palëve*.
- Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshojë apo të plotësohet sipas një marrëveshje me shkrim midis *palëve*.

Neni 6 - Kushtet e etikës së *Rrjetit*

- Anëtarët e *rrjetit* të tregojnë respekt për njëri-tjetrin, duke shmangur çdo formë të sjelljes ofenduese ose diskriminuese ose të padrejtë.
- Anëtarët e *rrjetit* të jenë transparent dhe të ndershëm në të gjitha veprimet, vendimet dhe komunikimet brenda tij.
- *Rrjeti* të sigurojë që të gjithë *palët* të kenë një mundësi të barabartë për të marrë pjesë, pavarësisht prejardhjes ose përkatësisë.
- *Rrjeti* të angazhohet me komunitetet lokale me respekt, duke marrë parasysh të drejtat dhe nevojat e tyre.
- *Rrjeti* të angazhohet për praktika të qëndrueshme që minimizojnë dëmtimin e mjedisit.
- Anëtarët e *rrjetit* të jenë transparent dhe të zbulojnë çdo interes personal ose organizativ që mund të ndikojë në aktivitetet e *rrjetit*.
- Anëtarët e *rrjetit* të mbrojnë informacionin e ndjeshëm që shpërndahet brenda *rrjetit*.
- *Rrjeti* të ruajë pavarësinë nga partitë politike, duke u fokusuar vetëm në objektivat mjedisore.
- *Rrjeti* të bazojë informacionin e ndarë në të dhëna të bazuara në fakte.
- *Rrjeti* të tregojë respekt për pronësinë intelektuale dhe të shmangët përdorimi i punës së të tjerëve pa leje.

Neni 7 - Kopjet dhe hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga *palët* e mëposhtëm.



Nënshkrimi i *palëve* të përfshira

Me nënshkrimin e këtij Memorandiumi, *palët* bien dakord për detajet më sipër.

Emri i individit/organizatës dhe përfaqësuesve

Data e nënshkrimit (dd.mm.yyyy)

<Emri i individit/organizatës>

<dd.mm.yyyy>

<Emri i përfaqësuesit (nëse është organizatë)>